



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 18.12.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.12.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NPN Dardania" për aktivitetin: "**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , debllokimi i kanalizimit atmosferik LOT 1, LOT2 ,LOT4 dhe LOT 6** " dhe me numër të prokurimit: 616 -18-025-211 nxjerr:

### V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "NPN Dardania" e datës 14.12.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , debllokimi i kanalizimit atmosferik LOT 1, LOT2 ,LOT4 dhe LOT 6** " me Nr. 616 18 440 211 Nr. Brendshëm : 616 -18-025-211 kundër *vendimit për dhënie të kontratës* te AK –së, të datës 10.12.2018 te publikuara ne web-faqe te KRPP-së.
2. Anullohet *njoftimi* i publikuar me datë: 10.12.2018 .
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te kete aktivitet ta kthej ne rivleresim.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "NPN Dardania" me datë 14.12.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ' **Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , debllokimi i kanalizimit atmosferik LOT 1, LOT2 ,LOT4 dhe LOT 6** " me numër të prokurimit Nr. 616 18 440 211 dhe numër të brendshëm 616 18 025 211. Autoriteti Kontraktues, me datë 18.12.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1. Lidhur me pretendimet per LOT 1 kemi konstatuar se lidhur me paisjet autocisterna duhet te kerkohet nje sqarim nga organet kompetetnte per dallimin ne mes autobotes dhe autocisternes ndersa lidhur me paisjen autocisterne me targa 03-164-ES pretendimi eshte i qendrueshem pasi qe sipas deshmive te ofruara ky mjet nuk e ploteson kapacitetin e kerkuar.
2. Lidhur me pretendimet per LOT 2 kemi konstatuar se eshte i bazuar pretendimi per mungesen e frezave te bores respektivisht qendron pretendimi se paisjet e ofruara nga OE-ik " Pastrimi" nuk jane freza te bores por motokultivator dhe nuk ka asnje deshmi se eshte bere ndonje modifikim per perdorim te tyre. Lidhur me pretendimin tjeter se OE-ik Pastrimi nuk ka ofruar kamioneta per barjen e mbeturinave me peshe 3.5 ton eshte konstatuar se ky pretendim eshte i pabazuar pasi qe ne oferten e OE-ik Pastrimi ekzistojne deshmite per paisjet me kete kapacitet.
3. Lidhur me pretendimet per LOT 4 kemi konstatuar se duhet kerkuar sqarimet per autobotat dhe autocisternat e ofruara , pasi qe ne disa shenon autobote ndersa ne tjerat autocisterne dhe nuk dihet saktesisht a jane te destinuar per bartjen e ujit apo per bartjen e naftes .Pretendimi per automjetin me targa 01-362- HB eshte i bazuar pasi qe nga deshmia dorezuar vertetohet se kapaciteti i tij eshte 5 ton .
4. Per LOT 6 kemi konstatuar se pretendimi per mos permbushjen e kerkeses lidhur me kamionetat per bartjen e mbeturinave eshte i pa qendrueshem pasi qe nga deshmite e ofruara vertetohet se te dy automjetet kane peshen prej 3.5 ton. Pretendimi tjeter qe ka te beje me autobotat eshte pjesrisht i bazuar dhe per kete eshte e domosdoshme qe ne procesin e rivleresimit te sqarohet nga organet kompetetente.

Bazuar ne konstatimet paraprake u vendos qe kjo lende te kthehte ne rivleresim per te gjitha pjeset , pasi qe duhet gjetur kombinimin me cmimin me te lire te mundshem per te gjitha pjeset.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit